

Plani i biznesit: Model për ndërmarrjet e reja

Ky dokument është gjedhe (shabllon) e planit të biznesit për ndërmarrjet publike që propozohet të themelohen. Mund të shërbejë si raport i arsyeshmërisë për themelimin e ndërmarrjes lokale në përputhje me nenin 5 të Rregullores (QRK) nr. 02/2013 mbi kriteret për krijimin e ndërmarrjeve publike lokale dhe pjesëmarrja e komunave në bordet e drejtorëve të ndërmarrjeve rajonale të ujit.

1. Përmbledhje ekzekutive

Këtu bëhet një përmbledhje e planit të biznesit, duke përshkruar pikat kryesore të secilit seksion. Të shkruhet në gjuhë të thjeshtë e të qartë.

2. Misioni dhe vizioni

Këtu deklarohet misioni dhe vizioni i ndërmarrjes që do të themelohet.

Deklarimi i misionit është përshkrim i thjeshtë i qëllimit dhe objektivave kryesore të ndërmarrjes. Mund të formulohet si përgjigje në pyetjen “Çka synon të bëjë ndërmarrja?” Për shembull, ndërmarrja synon të ofrojë shërbime cilësore, të shpejta dhe më të lira në mirëmbajtjen e ndërtesave publike dhe shumëbanesore për qytetarët e komunës.

Deklarimi i vizionit përshkruan ndikimin afatgjatë që ndërmarrja synon të ketë në sektorin ose territorin në të cilin zhvillon veprimtarinë. Deklarimi i vizionit mund të formulohet si përgjigje në pyetjen “Çka synon të arrijë ndërmarrja?” Për shembull, vizioni i ndërmarrjes është mjeshtëria e sigurt dhe i pastër, me hapësira të gjelbra dhe rrugë të qasshme për të gjithë qytetarët e komunës.

3. Veprimtaria

Këtu përshkruhen veprimtaritë e ndërmarrjes, që rëndom janë shërbimet që do të ofrojë ndërmarrja. Të jepet një listë e qartë dhe e hollësishme e veprimtarive, duke shmangur përgjithësimet. (Përshkrimi i veprimtarive mund të ndërlihet me analizën kosto-përfitim të investimeve kapitale.) Mund të përdoren kodet e klasifikimit të veprimtarive ekonomike NACE Rev. 2, të miratuara nga Agjencia e Statistikave të Kosovës dhe të zbatuara nga Agjencia e Regjistrimit të Bizneseve e Kosovës.

Një ndërmarrje në fillim nuk duhet të ushtrojë shumë veprimtari ose lloje të veprimtarisë që nuk përkojnë me njëra-tjetrën, pasi që nevojiten investime kapitale të shumta dhe vështirë të arsyetueshme, kërkohen shumë punëtorë me kualifikime të ndryshme, si dhe vështirësohet në përgjithësi menaxhimi i ndërmarrjes. Për shembull, një ndërmarrje mund të ofrojë mirëmbajtjen e parqeve dhe mirëmbajtjen e parkingjeve publike, që janë shërbime të ndryshme por që kërkojnë kryesisht të njëjtin kualifikim të stafit dhe pajisje të ngjashme të punës. Por e njëjta ndërmarrje nuk duhet të ofrojë njëherësh transportin e nxënësve dhe shërbimet e inxhinierisë, meqë këto janë aktivitete të ndara që kërkojnë investime kapitale të ndryshme, staf me kualifikime të ndryshme dhe mbikëqyrje të veçantë.

Ndërmarrja lokale nuk duhet të ofrojë shërbimet që i ofron një ndërmarrje tjetër publike, lokale ose rajonale. Për shembull, ndërmarrja lokale nuk duhet të themelohet për grumbullimin e mbeturinave, përderisa ekziston ndërmarrje rajonale për këtë veprimtari. Ndërmarrja lokale nuk mund të themelohet për shërbimet e ujësjellësit, që janë veprimtari e ndërmarrjeve qendrore me shtrirje rajonale.

Ndërmarrja lokale gjithashtu nuk duhet të ushtrojë veprimtari që me ligj janë kompetencë ekskluzive e nivelit qendror.

4. Konkurrenca

Këtu përshkruhet konkurrenca e drejtpërdrejtë e ndërmarrjes që do të themelohet. Ceken operatorët privatë që ofrojnë produktet apo shërbimet e njëjta ose të ngjashme. Sqarohet pse ndërmarrja e re ka përparësi ndaj konkurrencës — p.sh. çmimi më i ulët, shërbimi më cilësor, shërbimi më i shpejtë, ndikimi në mjedis, lehtësirat rreth procedurave të prokurimit etj.

5. Struktura dhe burimet njerëzore

Këtu sqarohet struktura organizative e ndërmarrjes që do të themelohet. Ceket forma e organizimit, që sipas ligjit duhet të jetë shoqëri aksionare. Paraqitet planifikimi i stafit, duke përfshirë numrin e paraparë, pozitat, pagat dhe kualifikimet e të punësuarve. Planifikimi i stafit mund të paraqitet në një tryezë.

6. Baza e klientëve dhe të hyrat

Këtu përshkruhet baza e klientëve dhe planifikimi i të hyrave. Baza e klientëve për ndërmarrjen lokale mund të jetë komuna ose qytetarët e komunës. Të hyrat mund të jenë nga kontratat e shërbimit, që lidhen me komunën ose qytetarët. Këtu mund të radhiten kontratat që komuna i ka të lidhura me operatorët privatë dhe të cilat synon t'ia kalojë ndërmarrjes publike pasi të themelohet. Të sqarohen përmbajtja e kontratës, shërbimet që përfshin, vlera e kontratës dhe afati i skadimit. Këto informata ndihmojnë për të planifikuar të hyrat e ndërmarrjes që do të themelohet.

7. Baza e furnitorëve dhe shpenzimet

Këtu paraqiten shpenzimet e planifikuara, që lidhen me ofrimin e shërbimeve të ndërmarrjes. Shpenzimet duhet të planifikohen krahas të hyrave. Planifikimi i shpenzimeve duhet të përfshijë: (1) shpenzimet e përgjithshme të ndërmarrjes, që planifikohen nga themelimi, dhe (2) shpenzimet për kontratat e veçanta, sipas kohës kur planifikohet të lidhet kontrata dhe të fillojë shërbimi.

Më poshtë është paraqitur një shembull i planifikimit të shpenzimeve sipas muajve, duke pasur parasysh kohën kur planifikohet të fillojnë shërbimet dhe shpenzimet e nevojshme për to (p.sh. pagat e punëtorëve të rinj, shpenzimet për mjete të punës etj.).

| Shpenz. | Përshkrimi | Muaji | | | | | | | | | | | | Shpenz. vjetor |
|--------------------------|--|--------------|--------------|--------------|--------------|--------------|--------------|--------------|--------------|--------------|--------------|--------------|--------------|----------------|
| | | 1 | 2 | 3 | 4 | 5 | 6 | 7 | 8 | 9 | 10 | 11 | 12 | |
| Komunalitet | | 200 | 200 | 250 | 250 | 250 | 300 | 300 | 300 | 300 | 300 | 400 | 400 | 3 450 |
| Paga | Shih planifikimin e stafit | 2 000 | 2 500 | 2 500 | 3 500 | 3 500 | 4 000 | 4 000 | 4 000 | 4 000 | 4 000 | 4 000 | 4 000 | 42 000 |
| Interneti | 30 euro/muaj x 12 muaj | 30 | 30 | 30 | 30 | 30 | 30 | 30 | 30 | 30 | 30 | 30 | 30 | 360 |
| Pajisje/material zyre | Letër, kapëse, foldera, vula, lapsa etj. | 300 | 100 | 100 | 200 | 200 | 300 | 200 | 200 | 100 | 300 | 200 | 200 | 2 400 |
| Pajisje/material mirëmb. | Dorëza, dorashka, leckë, qese, detergjent etj. | 500 | 400 | 400 | 500 | 400 | 400 | 300 | 500 | 400 | 400 | 400 | 500 | 5 100 |
| | Gjithsej | 3 030 | 3 230 | 3 280 | 4 480 | 4 380 | 5 030 | 4 830 | 5 030 | 4 830 | 5 030 | 5 030 | 5 130 | 53 310 |

8. Investimet kapitale dhe financimi

Këtu paraqiten plani i investimeve kapitale, që përfshijnë mjetet dhe pajisjet e nevojshme për fillimin e punës së ndërmarrjes (p.sh. kamionët, kompjuterët, orenditë e zyrës etj.) dhe çfarëdo

investimi tjetër kapital (p.sh. investimi në paluajtshmëri, pajisja me softver, pajisje me leje ose licencë etj.).

Para se të themelohet ndërmarrja, duhet të dihen se cilat mjete ose pajisje nevojiten për të ofruar shërbimet e synuara, sa kushtojnë ato, ku mund të sigurohen ose prokurohen dhe si do të financohet prokurimi.

Këtu duhet të përshkruhen në hollësi secilin mjet ose pajisje të nevojshme, duke përfshirë emërtimin, sasinë, çmimin, furnitorët që kanë dhënë oferta (nëse ka), si dhe funksionin ose arsyen pse nevojitet.

Tutje duhet të radhiten dhe të dëshmohen burimet e financimit. Financimi mund të jetë nga kapitali i aksionarit, nga grantet/donacionet ose përmes huas, sepse të hyrat e ndërmarrjes gjerohen më vonë. Burimet e financimit duhet të jenë konkrete dhe të qasshme. Kapitali i aksionarit duhet të mbështetet në ndarje ose planifikime buxhetore. Grantet që nuk janë fituar ose donacionet që nuk janë premtuar nuk mund të llogariten si burim financimi. Duhet të ceket gjithashtu nëse ka mjete ose pajisje që i dhurohen ndërmarrjes, nga aksionari ose pala tjetër, dhe që nuk ka nevojë të blihen. Dëshmitë e financimit mund të bashkëngjiten si shtojcë. Totali nga burimet e financimit duhet të mbulojë totalin e investimeve të planifikuara.

Investimet mund të arsyetohen përmes një analize kosto-përfitim, duke marrë parasysh veprimtaritë që do të ushtrojë ndërmarrja dhe veprimtaritë që mund t'u lihen operatorëve të tjerë.

Investimet duhet të planifikohen sipas planit të të hyrave, duke marrë parasysh kohën kur fillon ofrimi i shërbimeve. Nuk duhet të planifikohen për vitin e parë investimet kapitale që nevojiten për shërbime të cilat do të ofrohen tek në vitet vijuese, përveç nëse investimi kapital zgjat më shumë se një vit për t'u realizuar. Ngjashëm nuk duhet të planifikohen për vitin e parë të hyra nga ndonjë shërbim për të cilin ndërmarrja nuk ka planifikuar investim kapital, sepse mungojnë mjetet për të ofruar shërbimin dhe për të realizuar të hyrat.

Tryeza e mëposhtme është një shembull i përshkrimit të investimeve kapitale:

| Nr. | Mjeti | Përshkrim | Sasia (copë) | Çmimi | Gjithsej invest.kap. | Financimi |
|-----------------|-----------|--|--------------|-----------|----------------------|-----------------------|
| 1 | Kombi | Kombibus për bartjen e punëtorëve të mirëmbajtjes dhe veglave të punës | 1 | 30 000,00 | 30 000,00 | Kapital nga aksionari |
| 2 | Lopata | Lopata për mirëmbajtjen e hapësirave publike | 10 | 10,00 | 100,00 | Kapital nga aksionari |
| 3 | Fshesa | Fshesa për mirëmbajtjen e hapësirave publike | 10 | 10,00 | 100,00 | Kapital nga aksionari |
| 4 | Kontejner | Kontejner për mbledhjen e mbeturinave gjate mirëmbajtjes së hapësirave publike | 2 | 100,00 | 200,00 | Kapital nga aksionari |
| 5 | Kompjuter | Kompjuter për punët e administrative | 1 | 1 000,00 | 1 000,00 | Donacion |
| 6 | Karrige | Karrige për zyrën e ndërmarrjes | 1 | 100,00 | 100,00 | Donacion |
| 7 | Tavolina | Tavolinë për zyrën e ndërmarrjes | 1 | 200,00 | 200,00 | Donacion |
| 8 | Printer | Printer për punët administrative | 1 | 200,00 | 200,00 | Donacion |
| Gjithsej | | | | | 31 900,00 | |

Nëse ka shërbime shtesë që planifikohen të ofrohen në vitin e dytë të ndërmarrjes, të paraqiten investimet kapitale të planifikuara për vitin e dytë.

9. Buxheti

Këtu përshkruhet buxheti i planifikuar për tri vitet e para, në përputhje me planifikimin e të hyrave, shpenzimeve dhe investimeve kapitale të shtjelluara më sipër.

10. Shtojca

Këtu mund të jepen informata të tjera që themeluesi i ndërmarrjes konsideron të nevojshme. Mund të bashkëngjiten dokumente të rëndësishme si shtojca — për shembull, organogrami i ndërmarrjes, dëshmitë e burimeve të financimit, ndonjë raport mbi çështjet konkrete që ndër- lidhen me veprimtarinë e ndërmarrjes, ndonjë marrëveshje bashkëpunimi me palë të treta.